



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 255 Prot.

Tiranë, më 23/10/2023

V E N D I M
Nr. 57 datë 23 . 10 .2023

**PËR
FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E ANËTARËVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR” NË NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,
TIRANË**

Në zbatim të Nenit 4, 5, 6, 23 e në vijim, të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 të Senatit Akademik “Për miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” i ndryshuar, Urdhrin nr. 159, datë 20.10.2023 të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe në Urdhrin nr. 160, datë 20.10.2023 të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përhershëm për dhënie të gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, KIZ në mbledhjen e datës 23.10.2023:

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të përhershme për dhënie të gradës shkencore “Doktor” në:
 - 1) Fakultetin e Mjekësisë, UMT
 - 2) Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT
 - 3) Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, UMT
2. Të miratojë periudhën e zhvillimit të procesit zgjedhor nga data 23.10.2023 deri në 20.11.2023 dhe datën 20.11.2023, datën e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme për dhënie të gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të UMT-së sipas pikës 1.
3. Komisionet e Zgjedhjeve të Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të nisin procedurën e pranimit të aplikimeve sipas kriterëve, dokumentacionit dhe formularëve bashkëlidhur këtij vendimi për kandidatët që aplikojnë për anëtarë të Komisioneve të përhershme për dhënie të gradës shkencore “Doktor” në fakultete nga data 26.10.2023 deri

në datë 03.11.2023 dhe të shpallin listën përfundimtare të aplikantëve sipas përcaktimeve të Rregullores të Zgjedhjeve në UMT.

4. Formularët e aplikimit të dorëzohen pranë KZF së përkatëse, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi, si dhe në zbatim të Urdhrit të Rektorit të UMT-së nr. 159, datë 20.10.2023, *“Për përcaktimin e kritereve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtar të Komisionit të Përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”*
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në mjediset e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT, një kopje e tij i dërgohet KZF-ve të Fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë dhe drejtuesve të njësive kryesore të UMT.

KRYETAR
SILVANA BALA



Tiranë, më ____ / ____ /2023

VETËDEKLARIM

PËR KANDIDIMIN SI ANËTAR NË KOMISIONIN E PËRHERSHËM TË DHËNIES SË
GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" NË FAKULTETIN E

NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në zbatim të nenit 23 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", të ndryshuar, Urdhrit të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 159, datë 20.10.2023 "Për përcaktimin e kritereve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtar të Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor"....", Vendimit të KIZ nr. 57, datë 23.10.2023 "Për fillimin e procesit zgjedhor...",

Unë i/e nënshkruara z/znj,

Emër: _____

Atësi: _____

Mbiemër: _____

Gjinia: _____

Titulli akademik /Grada shkencore: _____

Vendi i punës (fakulteti): _____

paraqes kandidaturën time për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", në njësinë kryesore, Fakulteti i _____, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, që do të votohen nga personeli akademik me kohë të plotë në këtë fakultet, duke deklaruar se:

Në zbatim të detyrimeve ligjore, deklaroj nën përgjegjësin time të plotë dhe me vullnetin të lirë se:

- 1- Jam shtetas shqiptar dhe kam zotësi për të vepruar;
- 2- Jam personel akademik me kohë të plotë në Fakultetin e _____ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- 3- Nuk kam masë disiplinore në fuqi;
- 4- Nuk kam qenë dhe nuk jam i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra Penale dhe ndaj personit tim nuk është dhënë ndonjë masë e sigurimit personal;
- 5- Nuk kam shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" i ndryshuar.
- 6- Nuk kam shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

Emër, Mbiemër, Firma



7- Nuk jam anëtarë i Komisionit të Përhershëm i Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;

8- Deklaroj mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” e ndryshuar.

Bashkëlidhur këtij formulari vetëdeklarimi:

- 1- Dokument identifikimi ID/Pasaportë (fotokopje);
- 2- Kopje e njësuar me originalin të Titullit Akademik “_____” i marrë me Vendimin Nr. _____, datë _____ nga KVTA / KPPPA dhe regjistruar në AKKSHI/ ose vërtetimin nr. _____ prot., datë __/__/____.
- 3- Dëshmi penaliteti.
- 4- Vërtetim i aftësisë për punë.

Autorizoj Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të verifikoj në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve dhe deklaratës/deklaratave të paraqitura nga ana ime në këtë aplikim.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë ____/____/2023.

Emër, Mbiemër, Firma



Tiranë, më ____ / ____ /2023

Shtojca nr.1

FORMULAR DEKLARIMI

Mbi zbatimin e rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” e ndryshuar

Deklaruesi: _____

(emër)

(atësi)

(mbiemër)

Pozicioni: _____

(brenda UMT-së/ jashtë UMT-së)

Vendi i Punës: _____

Në mbështetje të nenit 19 / 20 / 21 / 22 / 23 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” e ndryshuar, unë Z./Znj. _____, kandidatë për _____, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e Gradës shkencore “Doktor” / Titullin akademik “Profesor i asociuar”/“Profesor”.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Nënshkruesi

Tiranë më: ____ / ____ /2023



Emër, Mbiemer, Firma
